



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-051

Prishtinë, më 4 dhjetor 2018, në orën 14:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 DHJETOR 2018

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi dhe Bilall Sherifi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Blerand Stavileci.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

1. Kërkesa e 42 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 42 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme më 4 dhjetor 2018 për debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.

Lidhur me kërkesën e 42 deputetëve të Kuvendit të Kosovës për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: Ahmet Isufi, kryetar i GP të AAK-së; Memli Krasniqi, kryetar i GP të PDK-së; Kujtim Shala, nënkryetar i Kuvendit; Ismet Krasniqi, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës; Dardan Sejdiu, kryetar i GP të PSD-së dhe Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartshënuara, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet të martën, më 4 dhjetor 2018, në orën 16:00, me këtë:

### **Rend dite**

1. Debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:00.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*